



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

DRAFT LAW ON INTERNATIONAL AGREEMENTS

NACRT ZAKONA O MEĐUNARODNIM UGOVORIMA



REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI	REPUBLIC OF KOSOVO ASSEMBLY	REPUBLIKA KOSOVO SKUPŠTINA
<p>Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p>	<p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p>	<p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p>
<p>Miratton:</p>	<p>Approves:</p>	<p>Usvaja:</p>
<p>LIGJIN PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE</p>	<p>LAW ON INTERNATIONAL AGREEMENTS</p>	<p>ZAKON O MEĐUNARODNIM UGOVORIMA</p>
<p>Neni 1 Qëllimi</p>	<p>Article 1 Purpose</p>	<p>Član 1 Domest aktivnosti</p>
<p>Ky ligj përcakton procedurën e negociimit, nënshkrimit, ratifikimit, rezervave dhe deklaratave, ndryshimit dhe plotësimit, tërheqjes, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, pavarësisht se cili institucion ose zyrtar ka lidhur ose nënshkruar marrëveshjet ndërkombëtare në emër të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p>	<p>The present law shall establish the procedure on negotiation, conclusion, ratification, reserves and declarations, amendment, withdrawal and implementation of international agreements of the Republic of Kosovo irrespective of which institution or officer has concluded or signed the International Agreements on behalf of the state and Republic of Kosovo in the prescribed manner.</p>	<p>Ovaj Zakon ustanovljuje proceduru za pregovaranje, potpisivanje, potvrđivanje, stavljanje rezervi i davanje izjava, izmenu i dopunu, otkazivanje, kao i sprovođenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo bez obzira na to koja institucija ili zvaničnik su zaključili ili potpisali dati međunarodni ugovor u ime države i vlade Republike Kosovo.</p>
<p>Neni 2 Pajtueshmëria me rregullat dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare</p>	<p>Article 2 Accordance with Rules and Principles of International Law</p>	<p>Član 2 Usklađenost sa normama i načelima međunarodnog prava</p>
<p>Ky ligj është në pajtim me rregullat dhe parimet e pranuar universale të së drejtës ndërkombëtare, që rregullojnë lidhjen dhe</p>	<p>This Law is in accordance with universally recognized rules and principles of international law regulating the conclusion</p>	<p>Ovaj zakon je usklađen sa opšte prihvaćenim normama i načelima međunarodnog prava koji uređuju</p>



<p>ekzekutimin e traktateve ndërkombëtare, të kodifikuara në Konventën e Vjenës të 23 majit 1969 për të Drejtën e Traktateve, Konventën e Vjenës të 14 marsit 1975 për Përfaqësimin e Shteteve në Marrëdhëniet e tyre me Organizatat Ndërkombëtare të Karakterit Universal, dhe Konventën e Vjenës të 21 marsit 1986 për të Drejtën e Traktateve ndërmjet Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose ndërmjet Organizatave Ndërkombëtare.</p>	<p>and execution of international treaties, and which were consolidated in the 23 May 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties, the 14 March 1975 Vienna Convention on the Representation of States in their Relations with International Organizations of a Universal Character, and in the 21 March 1986 Vienna Convention on the Law of Treaties between States and International Organizations or between International Organizations.</p>	<p>zaključenje i izvršenje međunarodnih ugovora, kodifikovanih u Bečkoj konvenciji o pravu međunarodnih ugovora od 23. maja 1969. godine, u Bečkoj konvenciji o predstavljanju država u odnosima sa međunarodnim organizacijama od 14. marta 1957. godine, i u Bečkoj konvenciji o pravu međunarodnih ugovora sklopljenih između država i međunarodnih organizacija ili samo između međunarodnih organizacija od 21. marta 1986. godine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Značenja izraza</p>
<p>1. Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. "Aderim" nënkupton aktin me të cilin Kuvendi ose Presidenti i Republikës së Kosovës jep miratimin që Republika e Kosovës të jetë palë në një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar prej saj;</p> <p>1.2. "Agjencitë shtetërore" ose "agjencitë shtetërore përkatëse" nënkupton institucionin fusha e kompetencave e të cilit mbulon fushëveprimin e marrëveshjes;</p> <p>1.3. "Autorizim" nënkupton një dokument që lëshohet nga autoriteti kompetent përmes</p>	<p>1. For the purposes of this Law, expressions used in this law have the following meaning:</p> <p>1.1. "Accession" shall mean the act by which the Assembly or the President of Republic of Kosovo gives the approval for Republic of Kosovo to become a party of a treaty or International Agreement, which is not signed by the them;</p> <p>1.2. "State Agencies" or "respective State Agencies" shall mean the institution, whose area of competencies covers the scope of activity of the agreement;</p> <p>1.3. "Authorization" shall mean a document issued by the competent body appointing</p>	<p>1. Za svrhe ovog zakona, upotrebljeni izrazi u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. "Pristupanje" označava akt kojim Skupština ili predsednik Republike Kosovo daju saglasnost da Republika Kosovo bude ugovorna strana u nekom sporazumu ili međunarodnom ugovoru koji nisu oni potpisali;</p> <p>1.2. "Državne agencije" ili "odnosne državne agencije" označavaju institucije čija oblast nadležnosti obuhvata predmet datog ugovora;</p> <p>1.3. "Punomoć" označava ispravu koju je izdao nadležni organ a kojom imenuje jedno</p>



<p>të cilit emëron një ose disa persona që përfaqësojnë atë në zhvillimin e bisedimeve ose nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare;</p> <p>1.4. "Deklaratë" nënkupton një deklaratë të njëanshme, të bërë nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një marrëveshjeje me anën e së cilës shprehet një kuptim ose interpretim i marrëveshjes, që nuk synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara;</p> <p>1.5. "Kryeministri" nënkupton Kryeministrin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.6. "Marrëveshje ndërkombëtare" nënkupton një marrëveshje ndërkombëtare të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare në formë të shkruar, e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura. Ky lloj i marrëveshjes ka kryesisht karakter politik;</p> <p>1.7. "Marrëveshje për bashkëpunim ndër-institucional" nënkupton një marrëveshje ose memorandum të lidhur në emër të, dhe në bazë të kompetencave të ministrive apo agjencive shtetërore dhe institucioneve të</p>	<p>one or few persons to represent it in negotiations or conclusion of an International Agreement;</p> <p>1.4. "Declaration" shall mean an unilateral declaration made by the competent state body at the time of conclusion, ratification, accession or approval of an agreement, expressing an understanding or interpretation of the agreement, not aiming to exclude or modify the legal effects of certain legal provisions;</p> <p>1.5. "The Prime Minister" shall mean the Prime Minister of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.6. "International Agreement" means an International Agreement concluded between the Republic of Kosovo and foreign states or international organizations in written form and governed by the International Law, whatever its particular designation and regardless of whether it is embodied in a single, two or more related instruments. This type of agreement is mainly of political nature;</p> <p>1.7. "Agreement on inter-institutional cooperation" shall mean an agreement or memorandum concluded on behalf of, and according to the competence of, the Ministries or state agencies and other</p>	<p>ili više lica da ga zastupaju u pregovorima ili u potpisivanju međunarodnih ugovora;</p> <p>1.4. "Izjava" označava neku jednostranu izjavu, koju je dao nadležni državni organ u vreme potpisivanja, potvrđivanja, pristupanja ili usvajanja nekog međunarodnog ugovora, kojom izražava određeno značenje ili tum ačenje datog međunarodnog ugovora kojenema za cilj da isključi ili preinači pravno dejstvo određene odredbe iz datog ugovora;</p> <p>1.5. "Premijer" označava premijera Republike Kosovo;</p> <p>1.6. "Međunarodni ugovor" označava neki međunarodni ugovor zaključen između Republike Kosovo i strane države ili međunarodne organizacije u pisanoj formi i prema pravilima međunarodnog prava, bez obzira na konkretnu sadržinu ili na činjenicu da li je sadržan u jednom, dva ili više povezanih instrumenata. Ova vrsta međunarodnog ugovora uglavnom je političke prirode;</p> <p>1.7. "Sporazum o međuinstitucionalonoj saradnji" označava neki sporazum ili memorandum zaključen u ime i shodno nadležnostima ministarstava ili državnih agencija i drugih institucija Republike</p>
--	---	---



<p>tjera të Republikës së Kosovës me institucionet dhe organizatat përkatëse të shteteve të huaja, që nuk lidhet në emër të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nuk është subjekt i ratifikimit. Ky lloj i marrëveshjes ka kryesisht karakter teknik;</p> <p>1.8. “Ministri i Punëve të Jashtme” nënkupton ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.9. “Ministria e Punëve të Jashtme” nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.10. “Ministritë” ose ministria nënkupton ministritë ose ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>1.11. “Parafim” nënkupton aktin me të cilin personat e autorizuar vënë inicialet për të treguar se kanë rënë dakord për tekstin përfundimtar të marrëveshjes;</p> <p>1.12. “Presidenti” nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.13. “Ratifikim” nënkupton aktin me të cilin Kuvendi ose Presidenti i Republikës së Kosovës jep miratimin përfundimtar për një marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, të nënshkruar në emër të</p>	<p>institutions of the Republic of Kosovo with the respective institutions and organizations of foreign states, that is not concluded on behalf of the State and the Government of the Republic of Kosovo and is not subject to ratification. This type of agreement is of technical nature;</p> <p>1.8. “Minister of Foreign Affairs” shall mean the Minister of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.9. “Ministry of Foreign Affairs” shall mean the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.10. “Ministries” or ministry shall mean ministries or a ministry of the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p>1.11. “Initials” shall mean the act by which authorized persons shall put their initials to witness their consent with the final text of the agreement;</p> <p>1.12. “The President” shall mean the President of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.13. “Ratification” shall mean the act by which the Assembly or the President of Republic of Kosovo gives its final approval for an international, bilateral or multilateral, agreement signed on behalf of Republic of</p>	<p>Kosova sa odgovarajućim institucijama i organizacijama strane države koji se ne zaključuje u ime države i vlade Republike Kosovo i koji nisu predmet potvrđivanja. Ova vrsta ugovora uglavnom je tehničke prirode;</p> <p>1.8. “Ministar inostranih poslova” označava ministra inostranih poslova Republike Kosovo;</p> <p>1.9. “Ministarstvo inostranih poslova” označava Ministarstvo inostranih poslova Republike Kosovo;</p> <p>1.10. “Ministarstvo” ili ministarstva označava ministarstva ili ministarstvo u vladi Republike Kosovo.</p> <p>1.11. “Parafiranje” označava akt kojim ovlašćena lica stavljaju svoje inicijale i time potvrđuju da je postignut konačni dogovor o tekstu ugovora;</p> <p>1.12. “Predsednik” označava predsednika Republike Kosovo</p> <p>1.13. “Potvrđivanje” označava akt kojim Skupština ili predsednik Republike Kosovo konačno usvajaju neki međunarodni ugovor, bilateralni ili multilateralni, koji je potpisan u ime Republike Kosovo;</p>
---	---	---



<p>Republikës së Kosovës;</p> <p>1.14. "Rezervë" nënkupton një deklaratë të njëanshme, të bërë nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një marrëveshjeje me anën e së cilës synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara;</p> <p>1.15. "Qeveria" nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.16. "Tërheqja" nënkupton aktin me të cilin Kuvendi, Presidenti ose Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh heqjen dorë nga një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 E drejta e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare</p> <p>1. E drejta e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe të Republikës së Kosovës i takon Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.</p> <p>2. Ministritë dhe agjencitë shtetërore kanë të drejtën e nismës së lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës për çështje që bien brenda kompetencave të tyre përkatëse.</p>	<p>Kosovo;</p> <p>1.14. "Reservations" shall mean an unilateral declaration made by the competent state body at the time of conclusion, ratification, adhesion or approval of an agreement which aims at excluding or modifying the legal impacts of certain provisions;</p> <p>1.15. "The Government" shall mean the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.16. "Denunciation" shall mean an act by which the Assembly, the President or the Government of the Republic of Kosovo expresses withdrawal from an international treaty or agreement.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Right of Initiative to Conclude International Agreements</p> <p>1. The right of initiative to conclude International bilateral or multilateral Agreements of the Republic of Kosovo shall be vested in the President, Prime Minister and Minister of Foreign Affairs.</p> <p>2. Ministries and state agencies shall have the right to initiate the conclusion of international agreements of the Republic of Kosovo on the issues falling within their respective competence.</p>	<p>1.14. "Rezerva" označava jednostranu izjavu koju daje nadležni državni organ prilikom potpisivanja, potvrđivanja, pristupanja ili usvajanja ugovora, čiji je cilj da isključi ili izmeni pravno dejstvo odredbe na koju je stavljena;</p> <p>1.15. "Vlada" označava vladu Republike Kosovo;</p> <p>1.16. "Otkazivanje ugovora" označava akt kojim Skupština, predsednik ili vlada Republike Kosovo otkazuju dalje važenje nekog ugovora ili međunarodnog ugovora.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Pravo na inicijativu za zaključivanje međunarodnih ugovora</p> <p>1. Pravo na pokretanje inicijative za zaključenje dvostranih ili višestranih međunarodnih ugovora Republike Kosovo imaju predsednik, premijer i ministar inostranih poslova.</p> <p>2. Ministarstva i državne agencije imaju pravo da iniciraju zaključenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo u pitanjima koja potpadaju pod njihovu odnosnu nadležnost.</p>
---	--	--



<p>3. Përgjegjësia bie mbi atë ministri apo agjenci shtetërore e cila ka iniciuar lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, përveç nëse Qeveria vendos ndryshe.</p> <p>4. Nisma për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe mund të merret nga autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës ose nga autoritetet e shteteve tjera.</p> <p>5. Nismat e marrëveshjeve ndërkombëtare që vijnë nga ministrinë miratohen në parim nga Qeveria, pas rekomandimit nga Ministria e Punëve të Jashtme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Marrja e vendimeve për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare</p> <p>1. Veprimet e ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës mund të merren vetëm nëse ka vendim për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjeve të tilla ndërkombëtare.</p> <p>2. Vendimet për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës merren në përputhje me kërkesat ligjore të Kushtetutës së Republikës së</p>	<p>3. Responsibility shall lie with that ministry or state agencies that initiated the conclusion of the International Agreement, unless the Government of the Republic of Kosovo decides otherwise.</p> <p>4. The initiative for the conclusion of a bilateral or multilateral international agreement may be taken by respective authorities of the Republic of Kosovo or by authorities of other states.</p> <p>5. The initiatives for international agreements deriving from ministries shall be approved, in principle, by the Government after receiving a recommendation by the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Taking Decisions on the Expediency of the Conclusion of International Agreements</p> <p>1. Acts relating to the conclusion of the International Agreement of the Republic of Kosovo may be taken only if there is a decision on the expediency of conclusion of such International Agreement.</p> <p>2. Decisions on the expediency of conclusion of International Agreements of the Republic of Kosovo shall be taken, in accordance with the legal requirements of</p>	<p>3. Odgovornost za zaključivanje leži na onom ministarstvu ili državnoj agenciji koja je inicirala zaključivanje međunarodnog ugovora, osim ukoliko Vlada o tome odluči drugačije.</p> <p>4. Inicijativu za zaključivanje dvostranih ili višestranih međunarodnih ugovora mogu da pokrenu nadležni organi Republike Kosovo ili organi stranih država.</p> <p>5. Inicijative za zaključivanje međunarodnih ugovora koje dođu iz ministarstava usvajaju se u načelu na Vladi na predlog Ministarstva spoljih poslova.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Odlučivanje o vremenskom roku za zaključenje međunarodnih ugovora</p> <p>1. Radnje u vezi sa zaključivanjem nekog međunarodnog ugovora Republike Kosovo mogu da se preduzimaju samo ako postoji odluka o vremenskom roku za zaključenje takvog međunarodnog ugovora</p> <p>2. Odluke o vremenskom roku za zaključenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo donosiće se u skladu sa pravnim zahtevima iz Ustava Republike</p>
--	---	---



<p>Kosovës, këtë ligj, ligjet e tjera të fushës përkatëse, si dhe të drejtën ndërkombëtare.</p> <p>3. Gjatë marrjes së vendimit për afatin kohor për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, merret parasysh përputhshmëria e projekt-marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, parimet themelore dhe objektivat e politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës, obligimet sipas këtij ligji, si dhe parimet dhe normat e të drejtës ndërkombëtare.</p> <p>4. Vendimi për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare merret nga Ministria e Punëve të Jashtme, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>5. Me dorëzimin e kërkesës në Ministrinë e Punëve të Jashtme për një vendim të tillë, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse dorëzon edhe projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare.</p> <p>6. Në rast se ministria ose agjencia shtetërore propozon nismën e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare pa dorëzuar projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare, atëherë ministria ose agjencia shtetërore përkatëse dorëzon një letër shpjeguese. Në letrën</p>	<p>the Constitution of the Republic of Kosovo, this Law, other laws on the relevant fields as well as international law.</p> <p>3. When taking a decision on expediency of the conclusion of an International Agreement of the Republic of Kosovo, conformity of the provisions of the draft International Agreement with the Constitution of the Republic of Kosovo, the basic principles and objectives of foreign policy and national security of the Republic of Kosovo, the requirements of this Law, the principles and norms of international law must be considered.</p> <p>4. The decision on the expediency of conclusion of the International Agreement shall be taken by the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p>5. Applying to the Ministry of Foreign Affairs for such a decision the responsible ministry or state agency shall submit the draft text of the International Agreement.</p> <p>6. When the responsible Ministry or state agency proposes the initiative for the conclusion of the International Agreement without having the draft text of the International Agreement, it shall submit an explanatory letter instead. In the</p>	<p>Kosovo, ovog Zakona, drugih zakona iz odnosnih oblasti kao i međunarodnog prava.</p> <p>3. Pri donošenju odluke o ekspedovanju zaključivanja nekog međunarodnog ugovora Republike Kosovo, moraju se razmotriti usklađenost odredaba nacрта međunarodnog ugovora sa Ustavom Republike Kosovo, sa osnovnim načelima i ciljevima spoljne politike i nacionalne bezbednosti Republike Kosovo, zahtevima sadržanim u ovom Zakonu, kao i sa načelima i normama međunarodnog prava.</p> <p>4. Odluku o vremenskom roku za zaključenje međunarodnog ugovora donosi Ministarstvo inostranih poslova.</p> <p>5. Uz svoje obraćanje Ministarstvu inostranih poslova za donošenje takve odluke, nadležno ministarstvo ili državna agencija dužni su da podnesu nacrt teksta međunarodnog ugovora.</p> <p>6. Kad nadležno ministarstvo ili državna agencija iniciraju zaključenje nekog međunarodnog ugovora bez priloženog nacрта teksta međunarodnog ugovora, onda su odnosno ministarstvo ili državna agencija dužni da umesto toga podnesu pismo s</p>
--	--	--



<p>shpjeguese, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse specifikon qëllimet dhe përshkruan dispozitat kryesore të marrëveshjes ndërkombëtare për të cilën bëhet kërkesa.</p> <p>7. Në rast se Ministria e Punëve të Jashtme, para marrjes së vendimit për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, ka dyshime rreth afatit kohor për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, atëherë mund të kërkojë nga ministritë ose agjencitë shtetërore përkatëse të dorëzojnë me shkrim opinionet e tyre rreth afatit kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare. Në qoftë se ministria ose agjencia shtetërore përkatëse nuk pajtohet me vendimin e marrë nga Ministria e Punëve të Jashtme për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare, çështja e afatit kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare vendoset nga Qeveria.</p> <p>8. Në qoftë se lidhja e marrëveshjes ndërkombëtare është e paraparë në një program ose dokument tjetër të Republikës së Kosovës të miratuar me ligj ose me ndonjë vendim të Qeverisë, atëherë konsiderohet se është marrë vendimi për afatin kohor për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare.</p> <p>9. Propozimet e bëra për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe tekstet e</p>	<p>explanatory letter, the ministry or state agency shall specify the purposes and describe the principal provisions of the International Agreement to be concluded.</p> <p>7. When the Ministry of Foreign Affairs has doubts about the expediency of conclusion of the International Agreement before taking the decision concerning the conclusion of the International Agreement, the Ministry may ask other relevant ministries or state agencies to submit, in writing, their opinions on the expediency of conclusion of the International Agreement. If the responsible ministry or state agency does not agree to the decision taken by the Ministry of Foreign Affairs on the expediency of conclusion of the International Agreement, the issue of the expediency of conclusion of the International Agreement shall be decided by the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p>8. When the conclusion of the International Agreement is provided for in a programme or other document approved by a law of the Republic of Kosovo or by a decision of the Government of the Republic of Kosovo, the decision on the expediency of conclusion of the International Agreement shall be deemed to have been already taken.</p> <p>9. Proposals for the conclusion of International Agreements made and their</p>	<p>objašnjenjem. U pismu s objašnjenjem, ministarstvo ili državna agencija dužni su da bliže odrede svrhu i da opišu glavne odredbe međunarodnog ugovora koji treba da bude zaključen.</p> <p>7. U slučaju da Ministarstvo inostranih poslova ima određene nedoumice u pogledu međunarodnog ugovora pre donošenja odluke u pogledu zaključivanja datog međunarodnog ugovora, Ministarstvo može da zatraži od drugih relevantnih ministarstava ili državnih agencija da podnesu u pisanoj formi svoja mišljenja o vremenskom roku za zaključenje datog međunarodnog ugovora. Ako se nadležno ministarstvo ili državna agencija ne saglase sa odlukom koju je donelo Ministarstvo inostranih poslova o vremenskom roku za zaključenje međunarodnog ugovora, pitanje vremenskom roku za zaključenje tog međunarodnog ugovora rešiće Vlada.</p> <p>8. Kad je zaključivanje međunarodnog ugovora predviđeno programom ili drugim dokumentom usvojenim nekim zakonom Republike Kosovo ili drugom odlukom Vlade, smatraće se da je doneta odluka o vremenskom roku za zaključenje tog međunarodnog ugovora.</p> <p>9. Sačinjeni predlozi za zaključivanje međunarodnog ugovora i nacrt njegovog</p>
---	---	--



<p>tyre në gjuhë shqipe dhe serbe, si dhe gjuhët e tjera të huaja përkatëse mund t'i dërgohen shteteve dhe organizatave ndërkombëtare të huaja vetëm përmes kanaleve diplomatike dhe vetëm pas marrjes së vendimit për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare, si dhe pas procedurës së shqyrtimit në pajtim me nenin 6 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Procedura e shqyrtimit të projekt marrëveshjeve ndërkombëtare</p> <p>1. Teksti i projekt marrëveshjes ndërkombëtare i hartuar nga një ministri ose agjenci shtetërore në gjuhët shqipe dhe serbe, si dhe në gjuhët e huaja përkatëse, nëse është i disponueshëm i dërgohet ministrive ose agjencive shtetërore përkatëse për shqyrtim.</p> <p>2. Projekti i tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme për shqyrtim vetëm pasi të jetë shqyrtuar dhe të jetë arritur pajtimi nga ministritë dhe agjencitë shtetërore përkatëse. Projekti i tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme bashkë me kopjet e opinionëve të pranuar nga ministritë ose agjencitë shtetërore përkatëse gjatë procedurës së shqyrtimit.</p>	<p>draft texts in the Albanian, Serbian and relevant foreign languages may be sent to foreign states and international organizations, only through diplomatic channels and only after the decision on the expediency of conclusion of the International Agreement has been made and the review procedure pursuant to Article 6 of this Law has been performed.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 The Procedural Review of the draft International Agreements</p> <p>1. The text of the draft International Agreement drafted by a particular ministry or state agency in the Albanian and Serbian languages, and in the relevant foreign language, if the text is available shall be sent to relevant ministries or state agencies for their review.</p> <p>2. The draft text of the International Agreement shall be sent to the Ministry of Foreign Affairs for review only after it has been reviewed and agreed to by all other relevant ministries and state agencies. The draft text of the International Agreement shall be sent to Ministry of Foreign Affairs together with copies of opinions received by other ministries or state agencies during the review procedure.</p>	<p>teksta na albanskom, srpskom i na relevantnom stranom jeziku mogu da budu prosleđeni stranim državama i međunarodnim organizacijama jedino putem diplomatskih kanala i jedino nakon donošenja odluke o ekspedovanju zaključivanja tog međunarodnog ugovora shodno članu 6 ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Procedura za razmatranje nacrt a međunarodnih ugovora</p> <p>1. Tekst nacrt a međunarodnog ugovora koji je napisalo neko ministarstvo ili državna agencija, na albanskom i srpskom jeziku i na relevantnom stranom jeziku, ako je tekst dostupan, šalje se nadležnim ministarstvima ili državnim agencijama na razmatranje.</p> <p>2. Nacrt teksta međunarodnog ugovora treba da bude prosleđen Ministarstvu inostranih poslova na razmatranje tek nakon što su ga razmotrila i prihvatila sva druga relevantna ministarstva i državne agencije. Nacrt teksta međunarodnog ugovora treba da bude prosleđen Ministarstvu inostranih poslova zajedno sa kopijama mišljenja dobijenih od drugih ministarstava ili državnih agencija u toku procedure razmatranja.</p>
---	--	--



<p>3. Ministria ose agjencia shtetërore përkatëse siguron përkthimin e projektit të tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe ose në gjuhën e huaj përkatëse.</p>	<p>3. The responsible ministry or state agency shall arrange for the translation of the draft text of the International Agreement into the Albanian and Serbian languages or into the relevant foreign language.</p>	<p>3. Nadležno ministarstvo ili državna agencija dužni su da obezbede prevođenje nacрта teksta međunarodnog ugovora na albanski i srpski jezik ili na relevantan strani jezik.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Powers to Conclude International Agreements</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Ovlašćenje za zaključenje međunarodnih ugovora</p>
<p>1. Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme kanë të drejtën e kryerjes së të gjitha veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, pa autorizime të veçanta.</p> <p>2. Shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës ose përfaqësuesi i autorizuar i Republikës së Kosovës në një konferencë ndërkombëtare, organizatë ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre ka të drejtën e negociimit të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose të miratojë tekstin me shtetin në të cilin është akredituar ose në konferencën ndërkombëtare, organizatën ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre.</p> <p>3. Personat tjerë, mund të kryejnë veprime drejt lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës vetëm me kusht që kanë fuqi të deleguara në bazë të ligjit në</p>	<p>1. The President and the Prime Minister and the Minister of Foreign Affairs shall be entitled without possessing special powers to perform all acts relating to the conclusion of the International Agreements of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The head of a diplomatic mission of the Republic of Kosovo or the authorized representative of the Republic of Kosovo at an international conference, international organization or one of its bodies shall be entitled to negotiate the conclusion of an International Agreement of the Republic of Kosovo or to approve its text with the State to which he is accredited or at the international conference, international organization or one of its bodies.</p> <p>3. Other persons may perform acts relating to the conclusion of the International Agreements of the Republic of Kosovo only provided they possess powers granted to</p>	<p>1. Predsednik, premijer i ministar inostranih poslova imaju pravo da bez ikakvog posebnog punomoćja vrše sve radnje koje se odnose na zaključenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo.</p> <p>2. Šef diplomatske misije Republike Kosovo ili ovlašćeni predstavnik Republike Kosovo na nekoj međunarodnoj konferenciji, u nekoj međunarodnoj organizaciji ili u nekom od njenih tela ovlašćeni su da pregovaraju o zaključenju nekog međunarodnog ugovora Republike Kosovo ili da prihvate tekst takvog ugovora sa državom u kojoj su akreditovani ili na međunarodnoj konferenciji, u nekoj međunarodnoj organizaciji ili u nekom od njenih tela.</p> <p>3. Druga lica mogu da vrše radnje koje se odnose na zaključenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo jedino pod uslovom da imaju punomoć koja im je data</p>



<p>fuqi dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Procedura për dhënien e autorizimit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare</p> <p>1. Kompetenca për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me fushat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 11 të këtij Ligji autorizohet nga Presidenti pas rekomandimit nga Qeveria.</p> <p>2. Kompetenca për të kryer veprimet e ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përveç atyre sipas paragrafit 1 të nenit 11 të këtij ligji, autorizohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.</p> <p>3. Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit, autorizohen nga Presidenti pas rekomandimit të ministrisë ose agjencisë shtetërore, kompetencë e së cilës është hartimi i marrëveshjes ndërkombëtare, me kusht që Ministria e Punëve të Jashtme të ketë dhënë pëlqimin paraprak për marrëveshjen përkatëse.</p>	<p>them on the basis of the laws in force and according to the procedure established in Article 7 of present Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Procedure for Granting Powers to Conclude International Agreements</p> <p>1. The powers to perform acts related to the conclusion of International Agreements of the Republic of Kosovo dealing with special areas as defined in Article 11, paragraph 1, of the present Law, shall be authorized by the President upon recommendation of the Government.</p> <p>2. The powers to perform the acts relating to the conclusion of International Agreements of the Republic of Kosovo other those referred to in paragraph 1 of Article 11 of this law, shall be granted by the Minister of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The powers for concluding International Agreements of the Republic of Kosovo which enter into force on the date of the signing thereof shall be granted by the President on the recommendation of the ministry or state agency within whose competence falls the drawing up of the, International Agreement provided the Ministry of Foreign Affairs has given its previous consent thereto.</p>	<p>na osnovu važećeg zakona i u skladu sa postupkom propisanim u članu 7 ovog Zakona</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Procedura za davanje punomoći za zaključenje međunarodnih ugovora</p> <p>1. Punomoć za vršenje radnji koje se odnose na zaključenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo koji se odnose na oblasti utvrđene u stavu 1 člana 11 ovog Zakona daje predsednik na predlog Vlade.</p> <p>2. Punomoć za vršenje drugih radnji koje se odnose na zaključenje međunarodnih ugovora Republike Kosovo osim onih iz stava 1 člana 11 ovog Zakona daje ministar inostranih poslova.</p> <p>3. Punomoć za zaključenje međunarodnog ugovora Republike Kosovo koje stupa na snagu danom njegovog potpisivanja daje predsednik na preporuku onog ministarstva ili državne agencije pod čiju nadležnost potpada izrada datog međunarodnog ugovora, pod uslovom da je na taj ugovor Ministarstvo inostranih poslova dalo svoju prethodnu saglasnost.</p>
---	--	--



<p>4. Kërkesës drejtuar Qeverisë për dhënien e autorizimit nga Presidenti për të kryer veprime që kanë të bëjnë me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1 të nenit 11, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse i bashkëngjet dokumentet në vijim:</p> <p>4.1. Projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;</p> <p>4.2. Opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;</p> <p>4.3. Vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare.</p> <p>5. Vendimi nxirret nga Qeveria për të kërkuar dhënien e autorizimit nga Presidenti. Vendimi i Qeverisë specifikon nenet ose paragrafët përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të këtij ligji.</p> <p>6. Kërkesës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për dhënien e autorizimit për të kryer veprime të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, përveç atyre të referuara në paragrafin 1 të nenit 11, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse i</p>	<p>4. Applying to the Government of the Republic of Kosovo for the granting of powers by the President to perform acts relating to the conclusion of the International Agreement referred to in Paragraph 1 of Article 11, the responsible ministry or state agency shall submit the following documents:</p> <p>4.1. The draft text of the International Agreement in the Albanian and Serbian languages, and, where applicable, in the relevant foreign language;</p> <p>4.2. Opinions submitted by ministries or state agencies during the review procedure;</p> <p>4.3. The decision of the Ministry of Foreign Affairs on the expediency of conclusion of the International Agreement;</p> <p>5. The decision shall be issued by the Government of the Republic of Kosovo to apply to the President for the granting of the powers. The decision shall specify the relevant Articles or paragraphs of the Constitution of the Republic of Kosovo and this law;</p> <p>6. Applying to the Ministry of Foreign Affairs for the granting of powers to perform acts relating to the conclusion of the International Agreement other than those referred to in Paragraph 1 of Article 11 of this Law, the responsible ministry or state</p>	<p>4. U svom obraćanju Vladi za dobijanje punomoći od predsednika za zaključenje međunarodnog ugovora iz stava 1 člana 11, nadležno ministarstvo ili državna agencija dužni su da prilože sledeća dokumenta:</p> <p>4.1. Nacrt teksta međunarodnog ugovora na albanskom i srpskom jeziku i, prema prilici, na relevantnom stranom jeziku;</p> <p>4.2. Mišljenja koja su dostavila druga ministarstva ili državne agencije u proceduri razmatranja;</p> <p>4.3. Odluku Ministarstva inostranih poslova o vremenskom roku za zaključenje međunarodnog ugovora</p> <p>5. Odluku koju treba da izda Vlada a odnosi se na davanje punomoći od strane predsednika. Odluka mora da navede relevantne članove odnosno stavove Ustava Republike Kosovo i ovog Zakona;</p> <p>6. Uz svoje obraćanje ministru inostranih poslova za davanje punomoći za vršenje radnji koje se odnose na zaključenje drugog međunarodnog ugovora osim onog iz stava 1 člana 11 ovog Zakona, nadležno ministarstvo ili državna agencija dužni su da</p>
--	---	---



<p>bashkëngjet dokumentet në vijim:</p> <p>6.1. Projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;</p> <p>6.2. Opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;</p> <p>7. Kërkesës së drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, ministria ose agjencia shtetërore i bashkëngjiten dokumentet në vijim:</p> <p>7.1. teksti i projekt marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;</p> <p>7.2. Opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;</p> <p>7.3. Vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare.</p>	<p>agency shall submit the following documents:</p> <p>6.1. The draft text of the International Agreement in the Albanian and Serbian languages, and, where applicable, in the relevant foreign language;</p> <p>6.2. Opinions submitted by ministries or state agencies during the review procedure;</p> <p>7. Applying to the President of the Republic of Kosovo for the granting of powers to perform acts relating to the conclusion of the International Agreement which enters into force on the moment of signature, the responsible ministry or state agency shall submit the following documents:</p> <p>7.1. The text of the draft International Agreement in the Albanian and Serbian languages, and, where applicable, in the relevant foreign language;</p> <p>7.2. Opinions submitted by ministries or state agencies during the review procedure;</p> <p>7.3. The decision of the Ministry of Foreign Affairs on the expediency of conclusion of the International Agreement.</p>	<p>podnesu sledeća dokumenta:</p> <p>6.1. Nacrt teksta međunarodnog ugovora na albanskom i srpskom jeziku, i prema prilici, na relevantnom stranom jeziku;</p> <p>6.2. Mišljenja koja su dostavila druga ministarstva ili državne agencije u proceduri razmatranja;</p> <p>7. Uz svoje obraćanje predsedniku Republike Kosovo za davanje punomoći za vršenje radnji koje se odnose na zaključenje međunarodnog ugovora koje stupa na snagu trenutkom potpisivanja, nadležno ministarstvo ili državna agencija dužni su da podnesu sledeća dokumenta:</p> <p>7.1. Tekst nacarta međunarodnog ugovora na albanskom i srpskom jeziku, i prema prilici, na relevantnom stranom jeziku;</p> <p>7.2. Mišljenja koja su dostavila druga ministarstva ili državne agencije u proceduri razmatranja;</p> <p>7.3. Odluke ministra inostranih poslova o vremenskom roku za zaključenje međunarodnih ugovora.</p>
---	---	---



<p>8. Presidenti dhe Ministria e Punëve të Jashtme japin autorizim, brenda afatit kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga data e pranimit të kërkesës nga Qeveria, respektivisht ministria ose agjencia shtetërore përkatëse. Autorizimet nënshkruhen nga Presidenti dhe Ministri i Punëve të Jashtme.</p> <p>9. Informatat për autorizimet nga Presidenti dhe Ministri i Punëve të Jashtme ruhen dhe administrohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Negociatat për marrëveshje ndërkombëtare</p> <p>1. Para fillimit të negociatave, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse propozon përbërjen e delegacionit, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen negociatat, pasi të jetë marrë më parë pëlqimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme.</p> <p>2. Pas çdo faze të negociatave të marrëveshjeve ndërkombëtare, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse raporton rreth përparimit dhe rezultateve të negociatave tek Ministria e Punëve të Jashtme. Çdo korrespondencë me organizatat e huaja shtetërore dhe ndërkombëtare rreth marrëveshjeve ndërkombëtare shkëmbehet</p>	<p>8. The President and Minister of Foreign Affairs shall issue full powers no later than within fifteen (15) working days of the date of receipt of the request by the Government, respectively the ministry or state agency. Full powers shall be signed by the President and the Minister of Foreign Affairs.</p> <p>9. Information about full powers shall be stored and administered at the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Negotiations of the International Agreement</p> <p>1. Prior to the commencement of negotiations, the relevant ministry or state agency shall propose the composition of the delegation, time and location for the negotiations to be held, after receiving the consent by the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p>2. After each stage of negotiations of the International Agreements, the responsible ministry or state agency shall report the progress and results of the negotiations to the Ministry of Foreign Affairs. Any correspondence with foreign states and international organizations regarding the International Agreements shall be</p>	<p>8. Predsednik i Ministarstvo inostranih poslova izdaju punomoćje u roku od petnaest (15) radnih dana od dana prijema zahteva od vlade ili od nadležnog ministarstva ili državne agencije. Redovne punomoći potpisuju predsednik i ministar inostranih poslova.</p> <p>9. Informacije o punomoćjima koje su dali predsednik i Ministarstvo inostranih poslova čuva i vodi Ministarstvo inostranih poslova.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Pregovaranje u cilju sklapanja međunarodnih ugovora</p> <p>1. Pre početka pregovaranja, nadležno ministarstvo ili državna agencija predlažu sastav delegacije, vreme i mesto kada i gde će se održati pregovori, posle prethodnog dobijanja saglasnosti od Ministarstva inostranih poslova.</p> <p>2. Posle svake faze pregovaranja u cilju zaključenja međunarodnog ugovora, nadležno ministarstvo ili državna agencija dužni su da podnesu izveštaj o ostvarenom napretku i rezultatima pregovaranja Ministarstvu inostranih poslova. Svaka prepiska sa stranim državama i međunarodnim organizacijama u pogledu</p>
---	---	---



